



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr. 60/01-7977/2018
Kaçanik, 16.03.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **I (Parë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 16 Mars .2018. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Tafili-LVV, Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Elmihane Krasniqi-Malsiu- nga HANDIKOS, Shemsedin Abazi nga KMLDNJ, Naim Hysa nga -Kryqi i Kuq

Në mbledhje ishte i ftuar të merr pjesë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kemal Mërseli në cilësi të Kryesimit të kësaj mbledhje deri me zgjedhjen e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Ylber Bajra, Nënkryetar i Komunës dhe Festim Neziraj, Drejtor i Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme.

Mbledhjen e Kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Kaltrina Luma, Asistente e Kryesuesit të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Përhëndeti të gjithë të pranishmit, e njoftoj Komitetin për Komunitete që e kam ftuar do të udhëheqë me këtë mbledhje deri me zgjedhjen e Kryesuesit të këtij Komiteti. Kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, për këtë takim kam propozuar këtë:

REND PUNE

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete,
2. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komitetit për Komunitete,
3. Mbyllja e mbledhjes.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

z. Shemsedin Abazi, Kjo është hera e dytë që jam anëtarë i Komitetit, ndërkaq kujtoj se kemi qenë të anashkaluar, nuk kemi qenë të informuar saktë për takimet e rregullta të këtij komiteti në bazë të Rregullores së Komiteteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Në bazë të Rregullores Komiteti për Komunitete mund të mbajë sa të dojë mbledhje, mirëpo me pagesë janë 4 mbledhje në vit, ashtu që

dy mbledhje do të mbahen në gjashtë mujorin e parë dhe dy në të dytin. Kjo është e përcaktuar edhe me Udhëzim Administrativ. Për këtë vit është miratuar buxheti i vitit 2018, vitin e ardhshëm mendoj se mund të bëjmë ndryshime buxhetore për çështjen e shtimit të mbledhjeve të Komuniteti për Komunitete . Ky Komitet themelohet ku ka pakica, mirëpo tek ne në mungesë të pakicave janë diskutuar çështje të shërbimit publik etj.

znj. Nazife Krasniqi, Unë nuk e di që janë të kufizuara mbledhjet e këtij Komiteti, ne nuk kemi minoritete, por kemi të drejtë para Kuvendit me i ngritur kërkesat që na adresohen nga komunitetet dhe kemi të drejtë me debatuar edhe çështje të tjera që janë në interes të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Ju jeni moti kohë këtu, ju znj. Nazife duhet ta dini që me ligj janë të parapara 4 mbledhje. Komitetet duhet të kenë një fushë të caktuar për të diskutuar, sepse për çështje që janë në kuadër të shërbimeve, pse të merren me arsim kur Komiteti për arsim merret me to, mirëpo pasi nuk kemi pakica ky komitet për me aranzhuar mbledhjen po duhet me gjetur ndonjë çështje të caktuar për me debatuar.

znj. Elmihane Krasniqi- Malsiu, Përshëndetje, un kam marrë pjesë edhe mandatin e kaluar, kemi pasur problem për arsye se nuk është përcjellë materiali i mbledhjes së KK edhe pse kemi bërë kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Si përfaqësuese e OJQ, ju mund te vini dhe t'i dëgjoni seancat e Kuvendit dhe te informoheni për aktivitetin e KK. Nëse nuk ka kush diçka, a mund të procedojmë me votim te hapur me ngritje te dorës për zgjedhjen e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete. Ky propozim u mbështet nga Komiteti për Komunitete. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, pyet se a ka kush propozim për Kryesues të Komitetit për Komunitete, procedojmë me propozime konkrete;

znj. Nazife Krasniqi, Unë propozoj, Kaltrina Tafili për Kryesuese të Komitetit për Komunitete.

z. Hajredin Luta, Unë propozoj, Lirije Luta për Kryesuese të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin e znj. Nazife Krasniqi që për Kryesuese të Komitetit për Komunitete të zgjidhet Kaltrina Tafili, e shtroj shtrua në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte 3 votë Për (Kaltrina Tafili, Elmihane Krasniqi-Malsiu dhe Nazife Krasniqi), Kundër ishin 4 votë (Hajredin Luta, Shemsedin Abazi, Naim Hysa dhe Lirije Luta). Në bazë të rezultatit të votimit, konstatohet se propozimi për zgjedhjen e Kaltrina Tafili për Kryesuese të Komitetit për Komunitete Nuk kaloj.

Pasi propozimi i parë nuk kaloj, atëherë Kryesuesi i Kuvendit –Kemal Mërseli, konstatoj me proceduar me propozimin e Hajredin Luta, që Lirije Luta të zgjidhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete. Këtë propozim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 4 votë Për (Hajredin Luta, Shemsedin Abazi, Naim Hysa dhe Lirije Luta), Kundër ishin: 3 anëtarë(Kaltrina Tafili, Elmihane Krasniqi-Malsiu dhe Nazife Krasniqi).

Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete, mori këtë:

VENDIM

Për zgjedhjen e Lirije Luta, për Kryesuese të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i uroj znj. Lirije Luta, shëndet dhe punë të mbarë në kryesimin e Komitetit për Komunitete. Me këtë rast ftoj znj. Lirije Luta për ta udhëhequr mbledhjen.

2. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komitetit për Komunitete,

znj. Lirije Luta, Faleminderit për dhe besimin që ma keni dhënë dëshiroj të kalojmë sa më mirë në aktivitetet e këtij komiteti.

Në bazë të nenit 53 të Komitetit për Komunitete 53.1 Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët e tjerë janë përfaqësuesit e Komuniteteve. Çdo Komunitet që jeton në Komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në Komunitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë në Komunë e përbejnë shumicën e anëtarëve të Komiteti të Komuniteteve.

53.2 Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së auditorëve Komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjithave politikave Komunale, praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e Komuniteteve për t'i avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komunës.

Në vazhdim znj. Luta pyeti, A dëshironi të diskutojmë sot Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018?

znj. Nazife Krasniqi, Urime znj. Lirije, unë ju kisha lutur që bashkëpunimi të jetë në nivel si dhe Plani i Punës së Komitetit për Komunitete të dorëzohet sa më shpejtë.

znj. Lirije Luta, Mua nuk me prishë punë, kur ju të jeni të gatshëm e mbajmë mbledhjen.

znj. Kaltrina Tafili, Duhet të jemi bashkëpunues në mes vete, kam shfletuar materiale që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete dhe e kam pa se në këtë segment ky komitet ka ngelë është mbrapa.

znj. Elmihane Krasniqi- Malsiu, Viteve të kaluara të gjithë kemi pasur nga një propozim në takim, pra secili ti jep mendimet e veta në takimin e radhës, mendoj se duhet të zgjidhet edhe Zëvendës Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, pasi që është në Udhëzim Administrativ.

znj. Lirije Luta, Nuk kemi minoritete, kështu që nuk e shoh të arsyeshme me pasur ky komitet edhe Zëvendës Kryesues.

znj. Nazife Krasniqi, Unë kujtoj se nuk e kemi të kufizuar zgjedhjen e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete. Edhe komuna, Hani i Elezit funksionin si ne dhe ka Zëvendës Kryesues.

z. Naim Hysa, Duhet që ta bëjmë Planin e punës, ndërkaq secili nga ne mund të fokusohemi me nga një propozim. Sa i përket mbledhjes së Komitetit për Komunitete, mundemi me e mbajt në çdo kohë.

znj. Kaltrina Tafili, duhet të fokusohemi në çështje kryesore që të kryejmë sa më shumë punë që i përket këtij komiteti.

znj. Lirije Luta, Këtu nuk ka interesa partiake, ne do mundohem të kryejmë sa me shumë punë lidhur me problemet të cilat i preokupojnë qytetarët e Komunës tonë, për çështjet të cilat bijnë në kompetencë të këtij komiteti.

z.Shemsedin Abazi, Mendoj se duhet te angazhohemi te gjithë që aktivitetet e kësaj trupe punuese të bëhen në frymën me të mirë.

3. Mbyllja e mbledhjes;

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Komitetit për Komunitete e konstatoi mbledhjen e përfunduar në ora 11.39

Procesmbajtës;
Kaltrina Luma

Kryesuesit e Komitetit për Komunitete;
1. Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
2.Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.